



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr. 970/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Nehat Idrizi, si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Burim Shala dhe Bujar Muzaqi, si anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit R. G., të cilin e përfaqëson i autorizuari P. P., avokat nga Prizreni, kundër të paditurve, A. C. nga Prizreni, dhe E. C. nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.50/17, i datës 08.09.2017, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 16.08.2021, mori këtë :

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa të autorizuarit të paditësit R. G. nga Prizreni, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.50/17, i datës 08.09.2017, në pikën II të dispozitivit, VËRTETOHET.

II. Mbetet i pa shqyrtuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 50/17, i datës 08.09.2017, në pikën I dhe III të dispozitivit.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.50/17, të datës 08.09.2017, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit R. G. nga Prizreni dhe vërtetohet se i njëjti është pronarë i parcelës Kadastrale 55617-12 sipërfaqja 304m², në vendin e quajtur “Bregu i Kuq”, arrë 3 klasë sipërfaqja 304m² në matjet dhe kufijtë, siç vijon: nga veri në gjatësi 8.52, nga 13.85, nga lindja 28.25m nga penëdimi nga thyerja deri tek thyerja 31.01m dhe parcela Kat. Nr. 5617-13 sipërfaqes nga 348 m² ZK Prizren në vendin e quajtur “Bregu i Kuq” arrë klase në matjet nga lindja thyrja deri tek thyerja 31.01m² nga perëndimi 29.25m që do të thotë se paditurit janë të detyruar të durojnë dhe të lejojnë se në bazë të aktgjykimit ky fakt ka të regjistrohet në Regjistrin e patundshmërive tek Zyra Komunale e Kadastrit të gjithë në afat nga 15 ditë nga plotfuqishmërisë të aktgjykimit nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar si jo të bazuar kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar të vërtetohet se ai është pronar i parcelës Kadastrale Nr. 5617-11 sipërfaqja 372 m² ZK

Prizren. Në pikën III të dispozitivit ka vendosur që secila palë ti mbartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, i autorizuar i paditësit në afatin ligjor ka ushtruar ankesë vetëm sa i përket pikës II të dispozitivit dhe atë për shkak të gjendjes faktike gabimisht të vërtetuar, shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit mbi procedurën kontestimore dhe aplikimit të gabuar të ligjit, me propozim bërë Gjykatës së Apelit që në procedurë të ankesës pjesën e aktgjykimi, pikën II të dispozitivit ta ndryshoi në mënyrë që është në ngastrën e përmendur kadastrale paditësit i pranohet e drejta e pronësisë, ose të njëjtin ta prish pjesërisht vetëm sa i përket pjesës refuzuese dhe për këtë pjesë çështjen ta kthej në gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje..

Ankesa e të autorizuarit të paditësit i është dorëzuar të paditurit për përgjigje por i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të autorizuarit të paditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi R. G. nga Prizreni përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi me datë 19.01.2017, kundër të paditurve A. C. nga Prizreni, dhe E. C. nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë, me të dhëna si në petitumin e kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike ka administruar provat ashtu siç është përcaktuar në arsyetim të aktgjykimin të atakuar dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.50/17, të datës 08.09.2017, me të cilën pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar..

Në arsyetim të aktgjykimin gjykata ka theksuar se në rastin konkret nuk është kontestuese se parcelat lëndorë kanë qenë në bashkëpronësi të paditurit të parë dhe vëllait të tij R., mbas vdekjes se tij dhe vdekjes së djalit të tij N., i kanë takuar E.Q. këtu paditurit të dytë. Është e qartë se ndarja fizike mes të vëllezërve nuk është bërë edhe më tutje këto parcelat evidentohet 1/2.

Tek kjo gjendja parcela kontestuese nr. 5617-11, sepse i padituri i parë e cek se ajo parcelë nuk është e atij dhe nuk ka mundur ta shesë, në anën tjetër edhe paditësi në deklaratën e tij e cek se shtëpinë e ndarë nga kjo parcelë 150m nga barutana e ka blerë djali i tij E. G. në vjeshtën e kaluar, nëntor 2016 nga I. nga nacionaliteti Rom, edhe atë e din djali i tij, ai nuk e din. Gjykata

ka vlerësuar deklaratën e paditësit në cilësinë e palës në kontestin dhe ka gjetur se i njëjti është në kundërshtim me deklaratat e tij të cekura në padinë dhe me prova të tjera të nxjerra nga arsyet të cilat nuk i njëjti nuk i pranoi. Ai pretendon se nuk e ka blerë parcelën nr. 5617-11, dhe me vetë atë nuk mundet të konsiderohet si pronari e as nuk i është i legjitimuar aktiv të kërkon t'ua pranon drejtën e pronësisë në këtë parcelë, nëse e ka blerë djali i tij. E cek se parcelën e ka blerë nga njëfarë I., e njëjta evidentohet në emër të paditurve ndërsa për fitimin e drejtë së pronësisë është e nevojshme mes tjerash se në sendin të dhënë ekziston e drejta e pronësisë së mbarësitë sepse pa atë drejtën e pronësisë nuk e fiton me punët juridike. Në parcelën e njëjtë nuk mundet të fiton drejtën e pronësisë më mirëbesim sepse nuk janë plotësuar kushtet ligjore.

Tutje ka arsyetuar se në bazë të nenit 20 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore pronësore juridike, si ligjit në fuqi në momentin e krijimit të marrëdhënies materialo juridike, drejtën e pronësisë fiton sipas vet Ligjit, në bazë të punës juridike dhe me trashëgimi. Një nga mënyrat e fitimit të ligjshëm të drejtës pronësore është mirëbesimi i cili nënkupton kalimin e kohës së caktuar. Paditësi është mbajtës i ligjshëm dhe me mirëbesim i cili nënkupton kalimin e kohës së caktuar. Paditësi është mbajtës i ligjshëm dhe me mirëbesim të patundshmërisë, sepse të njëjtën e ka blerë nga ana e ish pronarit me vitin 1970 dhe gjatë tërë viteve nuk e ka penguar në shfrytëzimin e patundshmërisë në kuptim të nenit 28 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike sipas të cilit është mbajtës i ligjshëm dhe mirëbesim të patundshmërisë, në të cilën tjetër kush ka drejtën e pronësisë. Duke u bazuar në këtë gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se janë përmbushur kushtet ligjore për konvalidimin e kësaj kontrate. Po ashtu në bazë të nenit 73 të LMD-së, si ligj në fuqi sipas të cilit kontrata për lidhjen e njëjtës kërkohet formë e shkruar, konsiderohet si e plotfuqishme, në rastin konkret edhe pse nuk është lidhur në atë formë nëse palët kontraktuese kanë ekzistuar apo në pjesën e madhe të detyrimit. Përveç nëse nga qëllimi e cila formë është paraparë është e dukshme se nuk rezulton gjë tjetër. Lidhur me shpenzimet gjykata ka vendosur në bazë të nenit 452 paragrafi 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar në pikën II të dispozitivit nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të autorizuarit të paditësit se aktgjykimi i ankimuar në pikën II të dispozitivit është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nuk qëndrojnë pasi në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë.

Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Përveç të cekurave arsyetimi i aktgjykimit përmban

edhe referencën sa i përket të drejtës materiale me shpjegime se si është zbatuar e drejta materiale në raport me gjendjen faktike të cilën e ka provuar gjykata e shkallës së parë në këtë çështje kontestuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkelje lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që në rastin konkret faktet vendimtare të çështjes të paraqitura nga palët ndërgjyqësore gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar plotësisht me provat e administruara në shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë nga ka rrjedhë edhe themelësia e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke mos e shqyrtuar pikën I dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar pasi që ankesa e të autorizuarit të paditësit nuk ka qenë e drejtuar ndaj pikës I dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

Nga se u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

Ac.nr.970/18, datë 16.08.2021

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,
Nehat Idrizi d.v